| 103 | **Sodium p-nitrophenolate**<br>CAS No 824-78-2<br>CIPAC number not allocated | Sodium 4-nitro phenolate; sodium p-nitrophenolate | ≥ 998 g/kg<br>Papastërtitë e mëposhtme janë shqetësuese toksikologjike:<br>Fenoli: max. 0,1 g/kg;<br>2,4 dinitrofenol max. 0,07 g/kg;<br>2,6 dinitrophenol max. 0,09 g/kg. | 1 nëntor 2009 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullues i rritjes së bimëve.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- specifikimin e materialit teknik si i prodhuar komercialisht, i cili duhet të konfirmohet dhe mbështetet nga të dhënat e duhura analitike. Materiali i provës i përdorur në dosjet e toksicitetit duhet të krahasohet dhe verifikohet kundrejt këtij specifikimi të materialit teknik;<br>- sigurinë e operatorëve dhe punëtorëve. Kushtet e përdorimit duhet të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale dhe masat për zbutjen e rrezikut për të reduktuar ekspozimin;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte tokash dhe/ose klimatike të cenueshme. Kushtet e regjistrimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Do të kërkohet paraqitja e studimeve të mëtejshme për të adresuar rrezikun për ujërat nëntokësore. |
| 104 | **Tebufenpyrad**<br>CAS No 119168-77-3<br>CIPAC No 725 | N-(4-tert-butyl benzyl)-4-chloro-3-ethyl-1-methyl pyrazole-5-carboxamide | ≥ 980 g/kg. | 1 nëntor 2009 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si akaricid dhe insekticid.<br>Në vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e PMB-ve që përmbajnë tebufenpyrad në formulime të ndryshme nga qeskat e tretshme në ujë, do t'u kushtohet vëmendje e veçantë kritereve dhe do të sigurohet çdo e dhënë e nevojshme informacioni përpara se të jepet një regjistrim i tillë.<br>Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe të punëtorëve dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe duhet të sigurohet që kushtet e regjistrimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, siç janë zonat tampon, sipas rastit;<br>- mbrojtjen e shpendëve insektngrënës dhe duhet të sigurohet që kushtet e regjistrimit përfshijnë, kur është e përshtatshme, masa për zbutjen e rrezikut.<br>Kërkuesi të paraqesë informacione të mëtejshme:<br>- që konfirmojnë se nuk ka papastërti përkatëse;<br>- për të adresuar më tej rrezikun për shpendët insektngrënës. |
| 105 | **Chlormequat**<br>CAS No 7003-89-6 (chlormequat)<br>CAS No 999-81-5 (chlormequat chloride)<br>CIPAC No 143 (chlormequat)<br>CIPAC No 143.302 (chlormequat chloride) | 2-chloroethyl trimethylammonium (chlormequat)<br>2-chloroethyl trimethylammonium chloride<br>(chlormequat chloride) | ≥ 636 g/kg<br>Papastërtitë 1,2-dikloretani: max. 0,1 g/kg (në përmbajtjen e klorurit të thatë të klormequat);<br>Kloroeteni (vinilklorur): max. 0,0005 g/kg (në përmbajtjen e klorurit të thatë të klormequat). | 1 dhjetor 2009 | 28 shkurt 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullator i rritjes së bimëve në drithëra dhe kultura jo të ngrënshme.<br>Në vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e PMB-ve që përmbajnë klormequat për përdorime të ndryshme nga thekra dhe triticalet, veçanërisht në lidhje me ekspozimin e konsumatorëve, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë kritereve dhe do të sigurohet çdo e dhënë dhe informacion i nevojshëm përpara se të jepet një regjistrim i tillë.<br>Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe të sigurojë që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e shpendëve dhe gjitarëve.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Do të kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm mbi fatin dhe sjelljen (studimet e absorbimit do të kryhen në 20°C, rillogaritja e përqendrimeve të parashikuara në ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe sedimentet), metodat e monitorimit për përcaktimin e substancës në produktet shtazore dhe ujin, dhe rrezikun për organizmat ujorë, zogjtë dhe gjitarët. |
| 106 | **Propaquizafop**<br>CAS No 111479-05-1<br>CIPAC No 173 | 2-isopropyli denamino-oxyethyl (R)-2-[4-(6-chloro-quinoxalin-2-yloxy)phenoxy]propionate | ≥ 920 g/kg<br>Tolueni: permbajtja max. 5 g/kg. | 1 dhjetor 2009 | 28 shkurt 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- specifikimin e materialit teknik si i prodhuar komercialisht i cili duhet të konfirmohet dhe mbështetet nga të dhënat e duhura analitike. Materiali i provës i përdorur në dosjet e toksicitetit duhet të krahasohet dhe verifikohet kundrejt këtij specifikimi të materialit teknik,<br>- sigurinë e operatorit dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe bimëve jo të synuara dhe të sigurohet që kushtet e autorizimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, siç janë zonat tampon, sipas rastit;<br>- mbrojtjen e artropodëve jo të synuar dhe të sigurohet që kushtet e regjistrimit përfshijnë, aty ku është e përshtatshme, masa për zbutjen e rrezikut.<br>Kërkuesi të paraqesë:<br>- informacione të mëtejshme mbi papastërtinë përkatëse Ro 41-5259;<br>- informacion për adresimin e mëtejshëm të rrezikut për organizmat ujorë dhe për artropodët që nuk synohen. |
| 107 | **Quizalofop-p** | | | | | |
| | **Quizalofop-P-tefuryl**<br>CAS No 119738-06-6<br>CIPAC No 641.226 | (RS)-Tetrahydro furfuryl (R)-2-[4-(6-chloroquino xalin-2-yloxy) phenoxy]propionat | ≥ 795 g/kg. | 1 dhjetor 2009 | 28 shkurt 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- specifikimin e materialit teknik si i prodhuar komercialisht i cili duhet të konfirmohet dhe mbështetet nga të dhënat e duhura analitike. Materiali i provës i përdorur në dosjet e toksicitetit duhet të krahasohet dhe verifikohet kundrejt këtij specifikimi të materialit teknik;<br>- sigurinë e operatorit dhe të punëtorëve dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e bimëve jo të synuara dhe të sigurohet që kushtet e autorizimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, siç janë zonat tampon, kur është e përshtatshme.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkuesi të dorëzojë informacion të mëtejshëm mbi rrezikun për artropodët që nuk synohen. |
| | **Quizalofop-P-ethyl**<br>CAS No 100646-51-3<br>CIPAC No 641.202 | ethyl (R)-2-[4-(6-chloroquinoxalin-2-yloxy)phenoxy] propionate | ≥ 950 g/kg. | 1 dhjetor 2009 | 28 shkurt 2027 | |
| 108 | **Dimethachlor**<br>CAS No 50563-36-5<br>CIPAC No 688 | 2-chloro-N-(2-methoxyethyl)acet-2',6'-xylidide | ≥ 950 g/kg<br>Papastërti 2,6-dimetilaniline: jo më shumë se 0,5 g/kg. | 1 janar 2010 | 15 tetor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid *në aplikim max. prej 1 kg/ha, çdo të tretin vit në të njëjtën fushë.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe bimëve jo të synuara; në lidhje me këto rreziqe të identifikuara, masat për zbutjen e rrezikut, të tilla si zonat tampon, do të zbatohen aty ku është e përshtatshme;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte tokash dhe/ose klimatike të cenueshme.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut dhe, programet e monitorimit do të nisin për të verifikuar ndotjen e mundshme të ujërave nëntokësore nga metabolitët CGA 50266, CGA 354742, CGA 102935 dhe SYN 528702 në zonat vulnerabël, sipas rastit.<br>Nëse dimetaklori klasifikohet si kancerogjen i kategorisë 2, do të kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm mbi rëndësinë e metabolitëve CGA 50266, CGA 354742, CGA 102935 dhe SYN 52870 ndaj kancerit. |
| 109 | **Etofenprox**<br>CAS No 80844-07-1<br>CIPAC No 471 | 2-(4-ethoxyphenyl) -2-methylpropyl 3-phenoxybenzyl ether | ≥ 980 g/kg. | 1 janar 2010 | 31 mars 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | - sigurinë e operatorit dhe të punëtorëve dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë; në lidhje me këto rreziqe të identifikuara, masat për zbutjen e rrezikut, të tilla si zonat tampon, do të zbatohen aty ku është e përshtatshme;<br>- mbrojtjen e bletëve dhe artropodëve jo të synuar; në lidhje me këto rreziqe të identifikuara, masat për zbutjen e rrezikut, të tilla si zonat tampon, do të zbatohen aty ku është e përshtatshme.<br>Kërkuesi të dorëzojë:<br>- informacione të mëtejshme mbi rrezikun për organizmat ujorë, duke përfshirë rrezikun për banorët e sedimentit dhe zmadhimin biologjik;<br>- studime të mëtejshme mbi potencialin e përçarjes endokrine në organizmat ujorë (studim i ciklit të plotë të jetës së peshkut). |
| 110 | **Penconazole**<br>CAS No 66246-88-6<br>CIPAC No 446 | (RS) 1-[2-(2,4-dichloro-phenyl)-pentyl]-1H-[1,2,4] triazole | ≥ 950 g/kg. | 1 janar 2010 | 15 tetor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte të pambrojtura toke dhe/ose klimatike.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Do të kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm mbi fatin dhe sjelljen e metabolitit të tokës CGA179944 në tokat acide. |
| 111 | **Tri-allate**<br>CAS No 2303-17-5<br>CIPAC No 97 | S-2,3,3-trichloro allyl di-isopropyl (thiocarbamate) | ≥ 940 g/kg<br>NDIPA (Nitroso-diisopropylamine) max. 0,02 mg/kg. | 1 janar 2010 | 31 mars 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- ekspozimin dietik i konsumatorëve ndaj mbetjeve të tri-alateve në kulturat e trajtuara, si dhe në kulturat pasuese me qarkullim dhe në produktet me origjinë shtazore;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe bimëve jo të synuara dhe të sigurohet që kushtet e regjistrimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, siç janë zonat tampon, sipas rastit;<br>- potencialit për ndotjen e ujërave nëntokësore nga produktet e degradimit TCPSA kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte toke dhe/ose klimatike të cenueshme. Kushtet e regjistrimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, sipas rastit.<br>Kërkuesi të paraqesë informacione të mëtejshme:<br>- për të vlerësuar metabolizmin primar të bimëve;<br>- mbi fatin dhe sjelljen e metabolitit të tokës diizopropilamine;<br>- mbi potencialin e biozmadhimit në zinxhirët ushqimorë ujorë;<br>- për të adresuar më tej rrezikun për gjitarët që hanë peshk dhe rrezikun afatgjatë për krimbat e tokës. |
| 112 | **Triflusulfuron** | | | 1 janar 2010 | 31 dhjetor 2023 | Çregjistruar. |
| 113 | **Sulphur**<br>CAS No 7704-34-9<br>CIPAC No 18 | Sulphur | ≥ 990 g/kg. | 1 janar 2010 | 31 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid dhe akaricid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë për mbrojtjen e shpendëve, gjitarëve, organizmave ujorë dhe artropodëve jo të synuar. Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkuesi të paraqesë informacione të mëtejshme për të konfirmuar vlerësimin e rrezikut për zogjtë, gjitarët, organizmat që banojnë në sediment dhe artropodët që nuk synojnë. |
| 114 | **Tetraconazole**<br>CAS No 112281-77-3<br>CIPAC No 726 | (RS)-2-(2,4-dichlorophenyl)-3-(1H-1.2,4-triazol-1-yl)-propyl-1.1,2, 2-tetrafluoroethyl ether | ≥ 950 g/kg (përzierje racemike).<br>Papastërtia e Toluenit: jo më shumë se 13 g/kg. | 1 janar 2010 | 31 mars 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe bimëve jo të synuara; në lidhje me këto rreziqe të identifikuara, masat për zbutjen e rrezikut, të tilla si zonat tampon, do të zbatohen aty ku është e përshtatshme;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur substanca aktive aplikohet në rajone me kushte tokash dhe/ose klimatike të cenueshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm:<br>- mbi një vlerësim të rafinuar të rrezikut të konsumatorit;<br>- mbi specifikimet në lidhje me ekotoksikologjinë;<br>- mbi fatin dhe sjelljen e metabolitëve të mundshëm në të gjitha ndarjet përkatëse; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | - për vlerësimin e rafinuar të rrezikut të këtyre metabolitëve për zogjtë, gjitarët, organizmat ujorë dhe artropodët jo të synuar;<br>- mbi potencialin e efekteve përçarëse endokrine te zogjtë, gjitarët dhe peshqit. |
| 115 | **Paraffin oils/**vajra parafine<br>CAS No 64742-46-7<br>CAS No 72623-86-0<br>CAS No 97862-82-3<br>CIPAC No n.a. | Paraffin oil | European Pharmacopoeia 6.0. | 1 janar 2010 | 31 mars 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid, akaricid dhe fungicid.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 116 | **Paraffin oil**/vaj parafine<br>CAS No 8042-47-5<br>CIPAC No n.a. | Paraffin oil | European Pharmacopoeia 6,0. | 1 janar 2010 | 30 nëntor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid dhe akaricid.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet dorëzimi i specifikimit të materialit teknik si i prodhuar komercialisht për të verifikuar përputhjen me kriteret e pastërtisë së Farmakopesë Evropiane 6,0. |
| 117 | **Cyflufenamid**<br>CAS No 180409-60-3<br>CIPAC No 759 | (Z)-N-[α-(cyclopro pylmethoxyimino) -2,3-difluoro-6-(trifluoromethyl) benzyl]-2-phenyl acetamide | > 980 g/kg. | 1 prill 2010 | 30 qershor 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së ujërave nëntokësore, kur substanca aktive aplikohet në rajone me tokë dhe/ose kushte klimatike të cenueshme.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 118 | **Fluopicolide**<br>CAS No<br>239110-15-7<br>CIPAC No 787 | 2,6-dichloro-N-[3-chloro-5-(trifluoro methyl)-2-pyridyl methyl]benzamide | ≥ 970 g/kg<br>Papastërtia e Toluenit nuk duhet të kalojë 3 g/kg në MT. | 1 qershor 2010 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore kur lënda vepruese aplikohet në rajone me tokë dhe/ose kushte klimatike të cenueshme;<br>- rrezikun për operatorët gjatë aplikimit;<br>- potencialin për transport me rreze të gjatë nëpërmjet ajrit.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut dhe, programet e monitorimit do të nisin për të verifikuar akumulimin dhe ekspozimin e mundshëm në zonat e cenueshme, sipas rastit. |
| 119 | **2-phenylphenol** (duke përfshirë kripërat e tij si kripa e natriumit)<br>CAS No 90-43-7<br>CIPAC No 246 | Biphenyl-2-ol | ≥ 998 g/kg. | 1 janar 2010 | 15 nëntor 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid *pas vjeljes për përdorim të brendshëm*.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve dhe për të siguruar që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- vendosjen e praktikave të përshtatshme të menaxhimit të mbetjeve për të trajtuar mbetjen e tretësirës pas aplikimit, duke përfshirë ujin e pastrimit të ujitjes dhe sistemeve të tjera të aplikimit.<br>Kërkuesi të paraqesë informacione të mëtejshme:<br>- mbi potencialin për depigmentim e lëkurës për punëtorët dhe konsumatorët për shkak të ekspozimit të mundshëm ndaj metabolitit 2-fenilhidrokinon (PHQ) në lëvozhgën e agrumeve;<br>- për të konfirmuar se metoda analitike e aplikuar në provat e mbetjeve përcakton saktë mbetjet e 2-fenilfenolit, PHQ dhe konjugatëve të tyre. |
| 120 | **Malathion**<br>CAS No 121-75-5<br>CIPAC No 12 | diethyl (dimethoxy phosphinothioylthio)succi nate<br>ose<br>S-1,2-bis (ethoxy carbonyl)ethyl O,O - dimethyl phosphorodithioate racemate | ≥ 950 g/kg<br>Papastërtia:<br>Isomalathion: jo më shumë se 2 g/kg. | 1 maj 2010 | 31 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid *në serra me strukturë të përhershme. Regjistrimet do të kufizohen për përdoruesit profesionistë.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- çlirimet nga serat, të tilla si uji i kondensimit, uji i kullimit, toka ose nënshtresa artificiale, me qëllim që të përjashtohen rreziqet për organizmat ujorë;<br>- mbrojtjen e kolonive të pjalmuesve të vendosura qëllimisht në serë;<br>- mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, në mënyrë që të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë përdorimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, sipas rastit;<br>- mbrojtjen e konsumatorëve në rastin e mallrave të përpunuara.<br>Formulimet me bazë malathion të shoqërohen nga udhëzimet e nevojshme për të shmangur çdo rrezik të formimit të izomalathionit që tejkalon sasinë maksimale të lejuar gjatë ruajtjes dhe transportit.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut dhe do të sigurojnë etiketim adekuat të produkteve për mbrojtjen e bimëve. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 121 | **Penoxsulam**<br>CAS No 219714-96-2<br>CIPAC No 758 | 3-(2,2-difluoro ethoxy)-N-(5,8-dimethoxy [1,2,4] triazolo[1,5-c] pyrimidin-2-yl)-α,α,α-trifluorotoluene-2-sulfonamide | > 980 g/kg<br>Papastërtia Bis-CHYMP<br>2-kloro-4-[2-(2-kloro-5-metoksi-4-pirimidinil) hidrazino]-5-metoksipirimidina deri 0,1 g/kg në MT. | 1 gusht 2010 | 15 maj 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë;<br>- ekspozimin dietik të konsumatorëve ndaj mbetjeve të metabolitit BSCTA në kulturat pasuese me rrotullim;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore kur substanca aktive aplikohet në rajone me kushte toke dhe/ose klimatike të cenueshme.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkuesi të dorëzojë informacione të mëtejshme për të adresuar rrezikun jashtë fushës për bimët më të larta ujore. |
| 122 | **Proquinazid**<br>CAS No 189278-12-4<br>CIPAC No 764 | 6-iodo-2-propoxy-3-propylquinazolin -4(3H)-one | > 950 g/kg | 1 gusht 2010 | 15 maj 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun afatgjatë për zogjtë që hanë krimbat e tokës, për përdorime në hardhi;<br>- rrezikun për organizmat ujorë;<br>- ekspozimin dietik të konsumatorëve ndaj mbetjeve të prokuinazidit në produktet me origjinë shtazore dhe në kulturat pasuese me qarkullim;<br>- sigurinë e operatorit.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 123 | **Metalaxyl**<br>CAS No 57837-19-1<br>CIPAC No 365 | Methyl N-(methoxyacetyl)-N-(2,6-xylyl)-DL-alaninate | 950 g/kg<br>Papastërtia 2,6-dimetilaniline konsiderohet si një shqetësim toksikologjik dhe vendoset një nivel max. prej 1 g/kg. | 1 korrik 2010 | 30 shtator 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë ndotjes së mundshme të ujërave nëntokësore nga lënda vepruese ose produktet e saj të degradimit CGA 62826 dhe CGA 108906 kur substanca aktive aplikohet në rajone me tokë dhe/ose kushte klimatike të cenueshme.<br>Masat për zbutjen e rrezikut duhet të zbatohen, aty ku është e nevojshme. |
| 124 | **Flonicamid** (IKI-220)<br>CAS No 158062-67-0<br>CIPAC No 763 | N-cyanomethyl-4-(trifluoromethyl)nicotinamide | ≥ 960 g/kg<br>Papastërtia e Toluenit deri 3 g/kg në MT. | 1 shtator 2010 | 30 nëntor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun për operatorët dhe punëtorët e rihyrjes;<br>- rrezikun për bletët.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 125 | **Sulfuryl fluoride**<br>CAS No 002699-79-8<br>CIPAC No 757 | Sulfuryl fluoride | > 994 g/kg. | 1 nëntor 2010 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid/nematicid (tymosës) *i aplikuar nga përdorues profesionistë në mjedise të mbyllura, për aq sa:*<br>*- këto mjedise janë bosh; ose*<br>*- mallrat ushqimore ose ushqimet për kafshë janë të pranishme në një objekt të tymosur, përdoruesit dhe operatorët e biznesit të ushqimit sigurojnë që vetëm produktet ushqimore ose ushqimet për kafshë janë në përputhje me nivelet maksimale ekzistuese të mbetjeve për fluorin sulfurik dhe jonin fluor, të përcaktuar nga legjislacioni për mbetjet; për këtë qëllim, përdoruesit dhe operatorët e biznesit ushqimor do të zbatojnë plotësisht masat ekuivalente me parimet HACCP; në veçanti, përdoruesit duhet të identifikojnë pikën kritike të kontrollit në të cilën kontrolli është thelbësor për të parandaluar tejkalimin e niveleve maksimale të mbetjeve dhe të vendosin dhe zbatojnë procedurat efektive të monitorimit në atë pikë kritike të kontrollit.*<br>Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun e paraqitur nga fluori inorganik nëpërmjet produkteve të kontaminuara, si mielli dhe krundet që mbeten në makineritë e mullirit gjatë tymosjes, ose drithërat e ruajtura në kapanone në mulli. Kërkohen masa për të siguruar që vetëm produktet që përputhen me MRL-të ekzistuese të hyjnë në zinxhirin ushqimor dhe ushqimet për kafshë;<br>- rrezikun për operatorët dhe për punëtorët, si për shembull kur hyjnë sërish në një mjedis të tymosur pas ajrimit. Kërkohen masa për të siguruar që ata të mbajnë aparate të frymëmarrjes ose pajisje të tjera të përshtatshme mbrojtëse personale;<br>- rrezikun për kalimtarët duke aplikuar një zonë të përshtatshme përjashtimi rreth mjedisit të tymosur.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkuesi duhet të paraqesë të dhëna monitoruese për përqendrimet troposferike të fluorit sulfurik çdo të pestin vit, duke filluar nga 30 qershor 2017. Kufiri i zbulimit për analizën duhet të jetë së paku 0,5 ppt (ekuivalent me 2,1 ng fluorid sulfurik/m³ ajër troposferik). |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 126 | **Napropamide**<br>CAS No 15299-99-7 | (RS)-N,N-diethyl-2-(1-naphthyloxy) propionamide | ≥ 930 g/kg<br>(Përzierje racemike)<br>Papastërtia përkatëse Tolueni: deri 1,4 g/kg. | 1 janar 2011 | 31 mars 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit; kushtet e përdorimit do të përshkruajnë përdorimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, kur është e nevojshme;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë; kushtet e regjistrimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, sipas rastit, të tilla si zona të përshtatshme mbrojtëse;<br>- sigurinë e konsumatorit, në lidhje me shfaqjen në ujërat nëntokësore të metabolitit 2-(1-naftiloksi)acidi propionik, në vijim "NOPA". |
| 127 | **Quinmerac**<br>CAS No 90717-03-6<br>CIPAC No 563 | 7-chloro-3-methylquinoline-8-carboxylic acid | ≥ 980 g/kg. | 1 maj 2011 | 31 dhjetor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte toke dhe/ose klimatike të cenueshme;<br>- ekspozimin dietik të konsumatorëve ndaj mbetjeve të quinmerac (dhe metabolitëve të tij) në kulturat pasuese me rrotullim;<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe rrezikun afatgjatë për krimbat e tokës.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit në lidhje me:<br>- potencialin e metabolizmit të bimëve për të rezultuar në një hapje të unazës së kinolinës;<br>- mbetjet në kulturat me qarkullim dhe rrezikun afatgjatë për krimbat e tokës për shkak të metabolitit BH 518-5. |
| 128 | **Pyridaben**<br>CAS No 96489-71-3<br>CIPAC No 583 | 2-tert-butyl-5-(4-tert-butylbenzyl thio)-4-chloropyri didazin-3(2H)-one | >980 g/kg. | 1 maj 2011 | 31 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid dhe akaricid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale kur është e përshtatshme;<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe gjitarët;<br>- rrezikun për artropodët jo të synuar, duke përfshirë bletët.<br>Kushtet e autorizimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut dhe duhet të iniciohen programe monitorimi për të verifikuar ekspozimin real të bletëve ndaj piridabenit në zonat e përdorura gjerësisht nga bletë të tilla për kërkim ushqimi ose nga bletarët, ku dhe sipas rastit.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- rreziqet e ujit që rezultojnë nga ekspozimi ndaj metabolitëve të fotolizës ujore W-1 dhe B-3;<br>- rrezikun e mundshëm afatgjatë për gjitarët;<br>- vlerësimin e mbetjeve të yndyrës (dhjamit) të tretshme. |
| 129 | **Zinc phosphide/**fosfidi i zinkut<br>CAS No 1314-84-7<br>CIPAC No 69 | Trizinc diphosphide | ≥ 800 g/kg. | 1 maj 2011 | 31 dhjetor 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rodenticid *në formën e karremave të gatshme, të vendosura në stacione karremi ose në pikat e synuara.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së organizmave jo të synuar. Masat për zbutjen e rrezikut duhet të zbatohen sipas rastit, në veçanti për të shmangur përhapjen e karremave ku vetëm një pjesë e përmbajtjes është konsumuar. |
| 130 | **Cycloxydim**<br>CAS No 101205-02-1<br>CIPAC No 510 | (5RS)-2-[(EZ)-1-(ethoxyimino)butyl]-3-hydroxy-5-[(3RS)-thian-3-yl] cyclohex-2-en-1-one | ≥ 940 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë rrezikut ndaj bimëve jo të synuara.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Do të kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm në lidhje me metodat për analizën e mbetjeve të cikloksidimit në produktet bimore dhe shtazore. |
| 131 | **6-Benzyladenine**<br>CAS No 1214-39-7<br>CIPAC No 829 | N6-benzyladenine | ≥ 973 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullator i rritjes së bimëve.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së organizmave ujorë.<br>Duhet të zbatohen masa për zbutjen e rrezikut si zonat buferike, aty ku është e nevojshme. |
| 132 | **Bromuconazole**<br>CAS No 116255-48-2<br>CIPAC No 680 | 1-[(2RS,4RS: 2RS,4SR)-4-bromo -2-(2,4-dichloro | ≥ 960 g/kg. | 1 shkurt 2011 | 30 prill 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | phenyl)tetrahydrofurfuryl]-1H-1,2,4-triazole | | | | - sigurinë e operatorit dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale aty ku është e përshtatshme;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë. Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e përshtatshme, të tilla si zona të përshtatshme tampon.<br>Kërkuesi të paraqesë informacione të mëtejshme:<br>- mbi mbetjet e metabolitëve të derivateve të triazolit (TDM) në kulturat primare, kulturat me qarkullim dhe produktet me origjinë shtazore;<br>- për të adresuar më tej rrezikun afatgjatë për gjitarët barngrënës. |
| 133 | **Buprofezin**<br>CAS No 953030-84-7<br>CIPAC No 681 | (Z)-2-tert-butyl imino-3-isopropyl-5-phenyl-1,3,5-thiadiazinan-4-one | ≥ 985 g/kg. | 1 shkurt 2011 | 15 dhjetor 2025 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid dhe akaricid *në kulturat e pa ngrënëshme.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorëve dhe punëtorëve dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të imponojnë përdorimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, kur është e përshtatshme;<br>- aplikimin e një periudhe të përshtatshme pritjeje për kulturat me qarkullim në serra;<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të imponojnë masa adekuate për zbutjen e rrezikut, aty ku është e përshtatshme.<br>Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 134 | **Hymexazol**<br>CAS No 10004-44-1<br>CIPAC No 528 | 5-methylisoxazol-3-ol (or 5-methyl-1,2-oxazol-3-ol) | ≥ 985 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid *për peletimin e farave të panxharit të sheqerit me pajisjet profesionale të trajtimit të farave.*<br>Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorëve dhe punëtorëve. Kushtet e autorizimit do të përfshijnë masa mbrojtëse, kur është e nevojshme;<br>- rrezikun për zogjtë granivorë dhe gjitarët.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Do të kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me natyrën e mbetjeve në kulturat rrënjësore dhe rrezikun për zogjtë granivorë dhe gjitarët. |
| 135 | **Dodine**<br>CAS No 2439-10-3<br>CIPAC No 101 | 1-dodecylguani dinium acetate | ≥ 950 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun e mundshëm afatgjatë për zogjtë dhe gjitarët;<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të imponojnë masa adekuate për zbutjen e rrezikut;<br>- rrezikun për impiantet jo të synuara në zonën jashtë fushës dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të imponojnë masa adekuate për zbutjen e rrezikut;<br>- monitorimin e niveleve të mbetjeve në frutat farore.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- vlerësimin afatgjatë të rrezikut për zogjtë dhe gjitarët;<br>- vlerësimin e rrezikut në sistemet natyrore të ujërave sipërfaqësore ku janë formuar potencialisht metabolitët kryesorë. |
| 136 | **Indolylbutyric acid**<br>CAS No 133-32-4<br>CIPAC No 830 | 4-(1H-indol-3-yl) butyric acid | ≥ 994 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 mars 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullues i rritjes së bimëve *në bimët zbukuruese.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë sigurisë së operatorëve dhe punëtorëve. Kushtet e regjistrimit do të përfshijnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale dhe masat për zbutjen e rrezikut për të reduktuar ekspozimin.<br>Do të kërkohet paraqitja e informacionit të mëtejshëm për të konfirmuar:<br>- mungesën e potencialit të klastogjenitetit të acidit indolilbutirik;<br>- presionin e avullit të acidit indolilbutirik dhe, rrjedhimisht, një studim i toksicitetit të inhalimit;<br>- përqendrimin natyror të acidit indolilbutirik në tokë. |
| 137 | **Tau-fluvalinate**<br>CAS No 102851-06-9<br>CIPAC No 786 | (RS)-α-cyano-3-phenoxybenzyl N-(2-chloro- α,α α- trifluoro-p-tolyl)-D-valinate<br>(Raporti i izomereve 1:1) | ≥ 920 g/kg<br>(1:1 raporti i R-α-cyano dhe S-α-cyano isomere)<br>Papastërtitë:<br>Tolueni deri 5 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si insekticid dhe akaricid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë zbatimin e masave adekuate për zbutjen e rrezikut; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | - rrezikun për artropodët që nuk synojnë dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë zbatimin e masave adekuate për zbutjen e rrezikut;<br>- materialin testues të përdorur në dosjet e toksicitetit, që duhet të krahasohet dhe verifikohet kundrejt specifikimeve të materialit teknik të prodhuar komercialisht.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- rrezikun e bioakumulimit/biozmadhimit në mjedisin ujor;<br>- rrezikun për artropodët që nuk synohen;<br>Kërkuesi të dorëzojë informacion konfirmues, dy vjet pas miratimit të udhëzimeve specifike, në lidhje me ndikimin e mundshëm në mjedis të degradimit të mundshëm enantio-selektiv në matricat mjedisore. |
| 138 | **Clethodim**<br>CAS No *99129-21-2*<br>CIPAC No 508 | (5RS)-2-{(1EZ)-1-[(2E)-3-chloroallyl oxyimino]propyl}-5-[(2RS)-2-(ethylthio)propyl]-3-hydroxycyclo hex-2-en-1-one | ≥ 930 g/kg<br>Papastërtitë:<br>Tolueni max. 4 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së organizmave ujorë, shpendëve dhe gjitarëve dhe duhet të sigurohet që kushtet e përdorimit të përfshijnë zbatimin e masave të përshtatshme për zbutjen e rrezikut.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, mbi bazën e njohurive më të fundit shkencore, në lidhje me:<br>- vlerësimet e ekspozimit të tokës dhe ujërave nëntokësore;<br>- përcaktimin e mbetjeve për vlerësimin e rrezikut. |
| 139 | **Bupirimate**<br>CAS No 41483-43-6<br>CIPAC No 261 | 5-butyl-2-ethyl amino-6-methyl pyrimidine-4-yl dimethylsulfamate | ≥ 945 g/kg<br>Papastërtitë:<br>Ethirimol: max. 2 g/kg;<br>Tolueni: max. 3 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë. Kushtet e autorizimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte tokash dhe/ose klimatike të cenueshme. Kushtet e autorizimit do të përfshijnë zbutjen e rrezikut, sipas rastit;<br>- rrezikun në terren për artropodët që nuk synohen.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- specifikimin e materialit teknik, siç është prodhuar komercialisht, nga të dhënat e duhura analitike, duke përfshirë informacionin mbi rëndësinë e papastërtive;<br>- ekuivalencën ndërmjet specifikimeve të materialit teknik, si të prodhuara komercialisht, dhe ato të materialit testues të përdorur në dosjet e toksicitetit;<br>- parametrat kinetikë, degradimin e tokës dhe parametrin e adsorbimit dhe desorbimit për metabolitin kryesor të tokës DE-B. |
| 140 | **1-decanol**<br>CAS No 112-30-1<br>CIPAC No 831 | Decan-1-ol | ≥ 960 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullator i rritjes së bimëve.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun për konsumatorët nga mbetjet në rast të përdorimit në kulturat ushqimore ose ushqimore;<br>- rrezikun për operatorin dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale aty ku është e përshtatshme;<br>-mbrojtjen e ujërave nëntokësore kur lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte toke dhe/ose klimatike të cenueshme;<br>- rrezikun për organizmat ujorë;<br>- rrezikun për artropodët dhe bletët jo të synuara që mund të ekspozohen ndaj lëndës vepruese, duke vizituar barërat e këqija të lulëzuara të pranishme në kulturën në kohën e aplikimit.<br>Masat për zbutjen e rrezikut do të zbatohen, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me rrezikun për organizmat ujorë dhe të informacionit që konfirmon vlerësimet e ekspozimit ndaj ujërave nëntokësore, sipërfaqësore dhe sedimenteve. |
| 141 | **Isoxaben**<br>CAS No 82558-50-7<br>CIPAC No 701 | N-[3-(1-ethyl-1-methylpropyl)-1,2-oxazol-5-yl]-2,6-dimethoxybenzamide | ≥ 910 g/kg<br>Tolueni: ≤ 3 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë rrezikut për organizmat ujorë, rrezikut për bimët tokësore jo të synuara dhe rrjedhjes së mundshme të metabolitëve në ujërat nëntokësore.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | - specifikimet e materialit teknik, siç është prodhuar komercialisht;<br>- rëndësinë e papastërtive;<br>- mbetjet në kulturat me qarkullim;<br>- rrezikun e mundshëm për organizmat ujorë. |
| 142 | **Fluometuron**<br>CAS No: 2164-17-2<br>CIPAC No: 159 | 1,1-dimethyl-3-(α,α,α -trifluoro-m-tolyl)urea | ≥ 940 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime si herbicid *vetëm në pambuk*.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve dhe të sigurohet që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>-mbrojtjen e ujërave nëntokësore ku lënda vepruese aplikohet në rajone me kushte toke dhe/ose klimatike të cenueshme; duhet të sigurohet që kushtet e autorizimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut dhe detyrimin për të kryer programe monitorimi për të verifikuar shpëlarjen e mundshme të fluometuronit dhe metabolitëve të tokës desmetil-fluometuron dhe trifluorometilaniline në zonat vulnerabël, sipas rastit;<br>- rrezikun për makroorganizmat e tjerë të tokës që nuk synohen, përveç krimbave të tokës dhe bimëve jo të synuara, dhe sigurohet që kushtet e autorizimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, sipas rastit.<br>Kërkuesi të paraqesë informacion konfirmues, në lidhje me:<br>- vetitë toksikologjike të acidit trifluoroacetik të metabolitit bimor;<br>- metodat analitike për monitorimin e fluometuronit në ajër;<br>- metodat analitike për monitorimin e metabolitit të tokës trifluorometilaniline në tokë dhe ujë;<br>- rëndësinë për ujin nëntokësor të metabolitëve të tokës desmetil-fluometuron dhe trifluorometilaniline, nëse fluometuroni klasifikohet si "i dyshuar për shkaktimin e kancerit". |
| 143 | **Dazomet**<br>CAS No 533-74-4<br>CIPAC No 146 | 3,5-dimethyl-1,3, 5-thiadiazinane-2-thione ose<br>tetrahydro-3,5-dimethyl-1,3,5-thiadiazine-2-thione | ≥ 950 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si nematicid, fungicid, herbicid dhe insekticid. Lejohet *vetëm aplikimi si tymosës i tokës. Përdorimi do të kufizohet në një aplikim çdo tre vjet*.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun për operatorët, punëtorët dhe kalimtarët;<br>- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur substanca aktive aplikohet në rajone me kushte tokash dhe/ose klimatike të cenueshme;<br>- rrezikun për organizmat ujorë.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- ndotjen e mundshme të ujërave nëntokësore nga metil izotiocianati;<br>- vlerësimin e potencialit të transportit atmosferik me rreze të gjatë të metilizotiocianatit dhe rreziqeve mjedisore të lidhura me to;<br>- rrezikun akut për zogjtë insektngrënës;<br>- rreziku afatgjatë për zogjtë dhe gjitarët. |
| 144 | **Metaldehyde**<br>CAS No 108-62-3 (tetramer)<br>9002-91-9 (homopolymer)<br>CIPAC No 62 | r-2, c-4, c-6, c-8-tetramethyl-1,3,5, 7-tetroxocane | ≥ 985 g/kg<br>Acetaldehyde max. 1,5 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si moluscicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- rrezikun për operatorët dhe punëtorët;<br>- situatën e ekspozimit dietik të konsumatorëve në funksion të rishikimeve të ardhshme të niveleve maksimale të mbetjeve;<br>- rrezikun akut dhe rrezikun afatgjatë për zogjtë dhe gjitarët.<br>Regjistrimet të përmbajnë një agjent efektiv kundër qenve.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 145 | **Sintofen**<br>CAS No 130561-48-7<br>CIPAC No 717 | 1-(4-chlorophenyl) -1,4-dihydro-5-(2-methoxyethoxy)-4-oxocinnoline-3-carboxylic acid | ≥ 980 g/kg<br>Papastërtitë:<br>2-metoksietanol, deri 0,25 g/kg;<br>N,N-dimetil formamide, deri 1,5 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si rregullator i rritjes së bimëve *për grurin për prodhimin e farave hibride, që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor*.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë rrezikut për operatorët dhe punëtorët dhe do të sigurohet që kushtet e përdorimit të përfshijnë zbatimin e masave adekuate për zbutjen e rrezikut. Gruri i trajtuar me sintofen të mos hyjë në zinxhirin ushqimor dhe ushqimet për kafshë.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | - specifikimet e materialit teknik, siç është prodhuar në mënyrë komerciale, të mbështetur nga të dhënat e duhura analitike;<br>- rëndësinë e papastërtive të pranishme në specifikimet teknike, me përjashtim të papastërtive 2-metoksietanol dhe N,N-dimetilformamide;<br>- rëndësinë e materialit testues të përdorur në dosjet e toksicitetit dhe ekotoksicitetit, në funksion të specifikimit të materialit teknik;<br>- profilin metabolik të sintofenit në kulturat me qarkullim. |
| 146 | **Fenazaquin**<br>CAS No 120928-09-8<br>CIPAC No 693 | 4-tert-butylphen ethyl quinazolin-4-yl ether | ≥ 975 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime *vetëm si akaricid në serra.*<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë;<br>- mbrojtjen e operatorëve, duke siguruar gjithashtu që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale;<br>- mbrojtjen e bletëve;<br>- rrezikun për bletët dhe bletët për pllenim, kur lënda vepruese aplikohet në serra;<br>- rrezikun për konsumatorët, veçanërisht nga mbetjet e krijuara gjatë përpunimit;<br>- kushtet e përdorimit për të shmangur ekspozimin ndaj mbetjeve të fenazaquin në lidhje me kulturat për konsum njerëzor dhe kafshë.<br>Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme. |
| 147 | **Azadirachtin**<br>CAS No 11141-17-6 (azadirachtin A)<br>CIPAC No 627 (azadirachtin A) | Azadirachtin A: dimethyl (2aR,3S,4S,4aR,5S, 7aS,8S,10R,10aS,10bR)-10-acetoxy-3,5-dihydroxy-4-[(1aR, 2S,3aS,6aS,7S,7aS)-6a-hydroxy-7a-methyl-3a,6a,7,7a-tetrahydro-2,7-methanofuro[2,3-b] oxireno[e]oxepin-1a (2H)-yl]-4-methyl-8-{[(2E)-2-methylbut-2-enoyl]oxy} octahydro-1H-naphtho[1,8a-c:4,5-b'c']difuran-5,10a (8H)-dicarboxylate. | Shprehur si azadirachtin A:<br>≥111 g/kg.<br>Shuma e aflatoksinave B1, B2, G1, G2 nuk duhet të kalojë 300 µg/kg të përmbajtjes së azadirachtin A. | 1 qershor 2011 | 31 janar 2027 | Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- ekspozimin dietik të konsumatorëve në funksion të rishikimeve të ardhshme të niveleve maksimale të mbetjeve;<br>- mbrojtjen e artropodëve dhe organizmave ujorë jo të synuar. Masat për zbutjen e rrezikut do të zbatohen aty ku është e nevojshme.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me marrëdhënien midis azadirachtines A dhe pjesës tjetër të përbërësve aktivë në ekstraktin e farave të neem për sasinë, aktivitetin biologjik dhe qëndrueshmërinë, në mënyrë që të konfirmohet përqasja e përbërjes aktive kryesuese në lidhje me azadirachtin A dhe për të konfirmuar specifikimet e materialit teknik, përcaktimin e mbetjeve dhe vlerësimin e rrezikut të ujërave nëntokësore. |
| 148 | **Diclofop**<br>CAS No 40843-25-2 (prind)<br>CAS No 257-141-8 (diclofop-methyl)<br>CIPAC No 358 (prind)<br>CIPAC No 358.201 (diclofop-methyl) | Diclofop (RS)-2-[4-(2,4-dichlorophenoxy) phenoxy]propionic acid<br>Diclofop-methyl methyl (RS)-2-[4-(2,4-dichloro phenoxy)phenoxy]propion ate | ≥ 980 g/kg (shprehur si diclofop-methyl). | 1 qershor 2011 | 31 gusht 2026 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si herbicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorëve dhe punëtorëve dhe, si kusht për regjistrim përfshijnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale;<br>- rrezikun për organizmat ujorë dhe bimët jo të synuara dhe kërkojnë zbatimin e masave për zbutjen e rrezikut.<br>Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me:<br>- një studim metabolizmi mbi drithërat;<br>- një përditësim i vlerësimit të rrezikut për ndikimin e mundshëm mjedisor të degradimit/konvertimit preferencial të izomerëve. |
| 149 | **Lime sulphur/** polisulfidi i kalciumit<br>CAS No 1344 - 81 - 6<br>CIPAC No 17 | Calcium polysulfide | ≥ 290 g/kg. | 1 qershor 2011 | 31 janar 2027 | Lejohen regjistrimet për përdorime vetëm si fungicid.<br>Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë, për:<br>- sigurinë e operatorit dhe duhet të sigurohet që kushtet e regjistrimit të përfshijnë masat e duhura mbrojtëse;<br>- mbrojtjen e organizmave ujorë dhe artropodëve jo të synuar dhe duhet të sigurohet që kushtet e përdorimit të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut sipas rastit. |
| 150 | **Aluminium sulfate**<br>CAS No 10043-01-3<br>CIPAC not available | Aluminium sulfate | 970 g/kg. | 1 qershor 2011 | 15 korrik 2026 | Lejohen regjistrimet vetëm për përdorime të brendshme si baktericid pas vjeljes për bimët zbukuruese. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kërkohet paraqitja e informacionit konfirmues, në lidhje me specifikimin e materialit teknik, siç është prodhuar në mënyrë komerciale, në formën e të dhënave të duhura analitike. |
